

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

1. Informacione te per gjitheshme

Shoqëria tregtare " ENERGY ALBANIA GROUP " SHPK , eshte themeluar si shoqeri me per gjigjesi te kufizuar më 15 maj 2010 , me administratore e shoqerise Znj. Anna Xheka dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri.

Kapitali rregistruar i saj është 100 000 leke dhe aktualisht pas ndryshimeve te bera ne date 03.12.2018 zotrohet nga :

- Shoqeria "GHIGGIA INGEGNERIA D'IMPIANTI S.R.L. " 50 % te kapitalit.
- Shoqeria "ETRA S.R.L. " 50 % te kapitalit.

Veprimitaria kryesore e shoqerise per ushtrimin 2018 ka qënë : Importimi i impianteve dhe pajisjeve te ndryshme per prodhimin e energjisë elektrike .

Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare(individuale) për qellime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standaret Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

2. Bazat e per gjatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë per gjatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

3. Politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara:

4.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimitari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërise dhe aktivitetë të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimitari investuese janë blerja, dhe nxjerra e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetë financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbëren e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

4.2 Aktivet dhe detyrimet financiare

Një aktiv finanziar ose një detyrim finanziar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi finanziar ose një detyrim finanziar bëhet me kostot e transaksionit(duke përfshirë edhe çmimin e trasaksonit) përvëç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion finanziar. Një transaksion finanziar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesit që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e aktivitit finanziar ose detyrimit finanziar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiare bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara ne pikën 7dhe 8 te SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të prishme për tu paguar ose arkëtuar, përvëçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interes i për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zgjedhjet dhe zgjedhimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njojur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit financiar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njojur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet financiar shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.

4.3 Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njojja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejtë të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njoftes, inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

4.4 Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyres të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

4.5 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitme të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi filletar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njoftje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njoftjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë viti ushtrimor.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivit. Përashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për g糟osje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi per te gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma te cilat janë të përaferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normalt e përdorura janë ne ndertesa 5 % te dhe per aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

4.6 Aktivet afatgjata jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktivi nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërise për një zë jomaterial. Njohja fillostarte e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

4.7 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtar apo për tu arkëtar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha reziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zoteron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëlli) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga intereseti njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëlli) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendiftët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtë ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

4.8 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në rjohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëherëshëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një javë ose një muaji mund të përdoret përfshirë gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zarat ne monedhë te huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijojnë gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin

Kur një përfitim ose humbje përfshin njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria përmendhat e huaja më kryesore, më 31.12.2018 janë 1 euro=123.42 leke dhe 1 dollar=107.82 leke.

4.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt ne kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuar në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet përfshin tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura përfshirë aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktivave dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin përmendhat 2018 eshte 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

4. Mjete Monetare (likuiditete në arke, bankë etj.)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne fillim dhe fund te ushtrimit janë si me poshtë:

Nr.	Përshkrimi i Elementeve	Monedha	Vlera raportues 31.12.2018	Vlera paraardhues 31.12.2017	
		Lekë	Value	Lekë	Value
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	1,585	-	21,022,821
2	Mjete monetare në bankë	Euro	30,107	244	3,321,493
	Mjete monetare në bankë	Lekë	20,106		10,497
	Mjete monetare në bankë	Usd	(483)	(4)	(450)
3	Investime në tregje shumë likuide	Lekë	-	-	-
	Shuma		51,315	239	24,354,361
					24,558

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund te ushtrimit. Tepicat e shprehura ne monedhë te huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit te shpallur nga B.Shqipërisë me 31.12.2018.

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

5. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Të drejtat e arketueshme, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen si vijon:

Nr.	Pershkrimi i Elementeve	Viti reportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)	7,186,859	-
2	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit	-	-
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike	-	-
4	Të Tjera (Debitore të tjerrë)	84,645	170,645
	Shteti-Tatim fitimi aktual		
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	84,645	170,645
	Huadhenie e përkoshme		
	Te tjera (furnitore debitore)		
5	Kapital i Nënshkruar i Papaguar	172,859,735	133,305,204
	Te drejta detyrime ndaj ortakeve		
	Shuma	172,944,380	140,662,708

Ne "Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)" ka faturat te papaguara per sherbimet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit .

6. Inventari

Nr.	Pershkrimi i Elementeve	Viti reportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1.	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	-	-
2.	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte	-	-
3.	Produkte të Gatshme	-	-
4.	Mallra	1,815,270	-
5.	Aktive Biologjike	-	-
6.	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
7.	Parapagime	-	-
	Shuma	1,815,270	

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2018.

7. Shpenzime të Shtyra

Ne vitin 2018 jane evidentuar shpenzime te shtyra ne vleren 1 331 943 lek .

8. Aktive Afatgjata Financiare

Nr.	Pershkrimi i Elementeve	Viti reportues 31.12.2018	Viti paraardhës 31.12.2017
1	Tituj Pronësie të Njësive Brenda Grupit	-	-
2	Aksionet e Veta	-	-
3	Të Tjera Financiare	-	-
	Shuma	-	-

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nuk jane evidentuar Aktive Afatgjata Financiare ne fund te ushtrimit.

9. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

Nr	Gjende (dhetëvjetës)	Toka/Te gjithë (Lek)	Nderesa	Implante dhe makineri	Te lera	Aktive afatgjata ne proces	Totali
(A)	Ngjarje e AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-
	Kohë e AAM-ve 31.12.2018	-	-	-	-	-	-
(B)	Amortizimi e AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi ushtrimi	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi e AAM-ve 31.12.2018	-	-	-	-	-	-
(C)	Zhvlerësimi e AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi e AAM-ve 31.12.2018	-	-	-	-	-	-
(D)	Vlera nete e AAM-ve 01.01.2018	-	-	-	-	-	-
(E)	Vlera nete e AAM-ve 31.12.2018	-	-	-	-	-	-

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit finansiar, jane matur me kosto.

Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e kostos dhe në pasqyrën e pozicionit finansiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2018.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve ështe metoda mbi vlerën e mbetur, e njejtë me atë që perdoret per qellime fiskale.

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar.

Drejtimi mendon se përgjithesisht në këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësimë.

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

11. Aktive Afatgjata Jo-Materiale

Nr.	Parashikimi i Elementeve	Vlera e përdorur 31.12.2018	Vlera parajdhetare 31.12.2017
-----	--------------------------	-----------------------------	-------------------------------

1. Aktive afatgjata jo materiale
2. Emri i Mire
3. Parapagime per Aktive Afatgjata Jo-Materiale

Shuma	
-	-

Nuk jane evidentuar Aktive Afatgjata Jo-Materiale ne fund te ushtrimit.

12. Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018 paraqiten:

Nr.	Parashikimi i Elementeve	Vlera e përdorur 31.12.2018	Vlera parajdhetare 31.12.2017
1	Titujt e Huamarjes	3,319,762	3,319,762
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	3,718,415	
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.	668,106	1,817,659
	Paga dhe shpërblime	666,474	1,816,843
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,632	816
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	-	86,000
	Shteti-Tatim mbi fitimin		
	Shteti-Tatim I thjeshtuar mbi fitimin		
	Tatim mbi të ardhurat personale	5,000	
	Debitore kreditore	81,000	
10	Të Tjera të Pagueshme	172,946,515	159,458,712
Shuma		176,934,383	168,400,548

"Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)" nuk rezulton me gjendje ne fund te ushtrimit.

"Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet." paraqet detyrimet e mbetur pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit dhjetor 2018

"Të Pagueshme për Detyrime Tatimore " perbehet nga tatimi ne burim i muajit te fundit qe do të paguhet në janar 2019 .

13. Detyrimet Afatgjata

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2018 paraqiten:

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr.	Pershkrimi / Elementeve	Viti raportues	Viti pararendhës
		31/12/2018	31/12/2017
1	Titujt e Huamarjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitet Shfrytezuese(Furnitore)	-	-
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme Ndaj Njës. Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme Ndaj Njës. Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Tjera të Pagueshme	-	-
	Shuma		

Nuk jane evidentuar detyrime afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel.

10. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqerisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit finanziar, është i njëjtë me atë të percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR.

Gjate ushtrimit kontabël nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e regjistruar të shoqerisë dhe ndryshime ne raportet zoterimit nga ortakët.

11. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Nr.	Pershkrimi / Elementeve	Viti raportues	Viti pararendhës
		31/12/2018	31/12/2017
1	Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:		
	Shitje e produkteve te gatëshme dhe nënprodukteve	-	-
	Shitja e punimeve dhe shërbimeve	-	-
	Shitja e mallrave	-	-
	Të ardhura nga shitje të tjera(qera,komisione,etj)	-	-
	Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	-	-
2	Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar	-	-
3	Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit	-	-
	Të ardhura nga Shitja e Aktiveve Afategjata	-	-
	Të ardhura të tjera(grante,te tjera,.....)	-	-
4	Ndryshimi në Inventarin e Produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
	Shuma		

Shoqeria nuk ka te ardhura nga aktiviteti per vitin 2018 .

12. Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018 (TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)

Nr.	Kategorija	Viti raportues	Viti paraardhës
		31.12.2018	31.12.2017
1	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		
	Lënda e Parë dhe Materiale		
	Mallra		
2	Të Tjera Shpenzime		

SHUMA

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar,raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet.
Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë :

Nr.	Kategorija	Viti raportues	Viti paraardhës
		31.12.2018	31.12.2017
1	Shpenzime Personeli		
	Paga dhe Shpërblime		
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore		
	Të tjera		
	Shuma		
2	Numri mesatar vjetor i të punësuarve		

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

14. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshire kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative,si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rjedhës normale të biznesit.

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr.	Përshtatje / Elemente	Viti raportues	Viti paraardhës
1	Të Tjera Shpenzime		
1	Shërbime nga të tretët(llog.61-62)	-	-
	Trajtime të përgjitheshme(nga të trete)	-	-
	Qera	-	-
	Mimbajtje dhe riparime	-	-
	Sigurime	-	-
	Personel jasht ndermarjes	-	-
	Transport per blerje	-	-
	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	-	-
	Shpenzime për shërbimet bankare	-	-
	Të tjera	-	-
3	Tatime dhe taksa(llog.63)	-	-
	Taksa dhe tarifa vendore	-	-
	Taksa te regjistrimit	-	-
	Tatime te tjera	-	-
4	Shpenzime të tjera jo korente(llog.67)	-	-
	Vlera kontabël e AA te shitura	-	-
	Te tjera	-	-
5	Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi(Gjoba,provizione) Llog.65,68)	-	7
	Shpenzime per pritje dhe përfaqësimë	-	-
	Gjoba dërmshpërblime	-	7
	Provizione	-	-
	Te tjera	-	-
	Shuma		

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane illogaritur dhe pasqyruar ne illogarite e ushtrimit.

Shpenzimet e tjera qe ne nje mase te konsiderueshme perbehen nga Furnitura , nentrajtime dhe sherbime nga te trete paraqitet e analizuar sipas pasqyres se mesiperme .

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2018 jane treguar ne pasqyren perkatese.

15. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Nr.	Përshtatje / Elemente	Viti raportues	Viti paraardhës
1	Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	-	-
2	Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	-	-
3	Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	-	-
4	Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	-	-
5	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	(1,815,278)	
	Shuma		(1,815,278)

Jane paraqitur si diferenca e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

16. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr. e reperi	Emitimi	Viti raportues	Viti paraardhës
		31.12.2018	31.12.2017
Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin			(1,815,278)
1 Fitimi/(Humbja) Para Tatimit			
2 Të ardhura të njoitura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-)	Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit dhe Të tjera(rimarrje provisionesh,gjobash etj)(-)	-	-
3 Shpenzime te panjohura tatimore(+)	Shpezime prite e dhurime tej kufirit tatimor(+) Gjoba,penalitetë,demshperblime(+) Amortizim mbi normat fiskale(+) Provizione per rreziqe e shpenzime(+)	-	-
Të tjera		1,815,278	
Diferencia pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njojet për			
4 qëllimet e raportimit(-)	Amortizimi i përshtetuar tatimor(-) Të tjera(-)	-	-
5 Zbritja e humbjes tatimore(-)		-	-
6 Fitimi I Tatueshmë-Humbja Fiskale(1+2+3+4+5)		-	
Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(2015-15%)			
Shpenzimi(të ardhura) i Tatimit mbi Shtyre(+)			
Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(+)			
Fitimi/(Humbja) e Viti Financiar			(1,815,278)

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyre, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve.

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal.Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 15%.

17. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

18. Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marrjen në konsiderate të çdo transaksi dhe marredhenie të mundeshme, jo thjesht formen ligjore të tyre ne 31 dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

19. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2016 janë riparaqitur sipas këtyre zërave.

Administrator

ANNA XHEKA



Hartuesi/Financieri

KONTABELI MIRATUAR

KRISTAQ MAMILLO

KRISTAQ MAMILLO


Page 11 nga 11

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

		Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vtit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
►	Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000						(891,466)		(791,466)		
	Efekti i ndryshimeve në politikat											
►	Pozicioni financiar i ridekluar më 1 janar 2017	100,000						(891,466)		(791,466)		
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse përvitin:											
	Fitimi / Humbja e vtit											
	Të ardhura të tjera											
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse përvitin:											
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njoitura direkt në kapital:											
	Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
	Dividendë të paguar											
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
►	Pozicioni financiar i ridekluar më 31 dhjetor 2017	100,000						(891,466)		(791,466)		
►	Pozicioni financiar i ridekluar më 1 janar 2018	100,000						(891,466)		(791,466)		
	Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse përvitin:											
	Fitimi / Humbja e vtit								(1,815,278)			
	Të ardhura të tjera											
	Të ardhura totale gjithëpërfshirëse përvitin:											
	Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njoitura direkt në											
	Emetimi i kapitalit të nënshkruar											
	Dividendë të paguar											
	Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike											
►	Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000						(891,466)	(1,815,278)	(2,606,744)		

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

KRISTAQ MAMILLO
KRISTAQ MAMILLO



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

ANNA XHEKA

ENERGY ALBANIA GROUP SHPK

PASQYRAT FINANCIARE 2018

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018
(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEKË)**

Nr.	Emri/Emri i tregimit	Viti pothuas	Viti pothendje
		31.12.2018	31.12.2017
I	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(1)		(1.315.278)
1	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit		
2	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-) Dividentët e dekluaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kontrollit dhe Të tjera(rimarrje provisionesh,gjobash etj)(-)		-
3	Shpenzime te panjohura tatimore(+) Shpezime priti e dhurime tej kufirit tatimor(+) Gjoba,penalite, demshperblime(+) Amortizim mbi normat fiskale(+) Provizione per rreziqe e shpenzime(+) Të tjera		-
	Diferencia pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet për	1,815,278	
4	qëllimet e raportimit(-) Amortizimi i përshtetuar tatimor(-) Të tjera(-)		-
5	Zbritja e humbjes tatimore(-)		-
6	Fitimi i Tatueshëm-Humbja Fiskale(1+2+3+4+5)		
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(2015-16%)		
	Shpenzimi(të ardhura) i Tatimit Fitimi(1.315 Shpyrë)(2)		
	Shpenzimi(të ardhura) por Tatimin mbi Fitimin(3:1)		
	Fitimi/(Humbja) e Vites Financiare	(1.315.278)	

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyre, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferençave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve.

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kerkesat e legjisacionit fiskal.Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 15%.

17. Ngjarjet pas datës se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

18. Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marjen në konsiderate të çdo transaksi dhe marredhenie të mundeshme, jo thjesht formen ligjore të tyre ne 31 dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

19. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2016 janë riparaqitur sipas këtyre zëra.

Administratore

ANNA XHEKA

Hartuesi/Financieri

KONTAKU I MIRATUAR
KRISTAQ MAMILLO
KRISTAQ MAMILLO

Faqë 11 nga 11